



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 253 Prot.

Tiranë, më 9 . 2 2017

V E N D I M

“Mbi lejimin e transferimit ndërkombëtar”

Nr. 15 , datë 9/2 2017

Në mbështetje të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës administruar me nr. 1477 prot, datë 14.12.2016, për pajisje me autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale nga transferuesi **AVON COSMETICS Albania Sh.p.k (“AVON”)** në marrësin **HP ENTERPRISE SERVICES LLC, UNITED STATES OF AMERICA (SHBA)**;

K O N S T A T O V A :

Subjekti kontrollues, **AVON COSMETICS Albania Sh.p.k** ka kërkuar nga Zyra e Komisionerit pajisjen me autorizim për transferimin e të dhënave personale në marrësin **HP Enterprise Services LLC** të vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sipas deklarimeve të subjektit në *Formularin e Aplikimit për Aprovimin e Transferimit të të Dhënave Personale në një Shtet që nuk ka Nivel të Mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave*, administruar pranë KDIMDP, transferimi që kërkohet të autorizohet nga Autoriteti i Komisionerit përmban elementët e mëposhtëm:

Kategoria e të dhënave objekt transferimi:

1. Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
2. Numri personal i identifikimit;
3. Jeta profesionale;
4. Numri i sigurimit shoqëror;
5. Formimi, Diplomat, Medaljet;
6. Adresa, (karakteristikat e banesës);
7. Telefoni fiks, të dhëna bankare, kontakt emergjence.

Shteti ku do të realizohet transferimi: SHBA.

Kategoria e subjekteve të cilëve u transferohen të dhënat personale janë:

1. Punëmarrës;
2. Përfaqësuesit e kontrolluesit.

Frekuenca e Transferimit është: Vazhdimisht.

Qëllimi i transferimit, citojmë: *“Në kuadrin e përforcimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, Avonit ti mundësohet outsourcing disa shërbimeve të teknologjisë së informacionit HP Enterprise Services (“HPES”)”.*

Ndërkohë në Rubrikën 7, të Formularit të Aplikimit *“Rrethanat lidhur me përpunimin”* subjekti transferues ka deklaruar, citojmë: *“Shërbimet që HPES do t'i japë Avon ndahen në pesë kategori:*

- *Ndër funksionale (Cross Functional) – Procese menazhuese supporti ITIL (Information Technology Infrastructure Library) për procese infrastrukture, koordinimi i proceseve menazhuese ITIL shërbime të zbatuara dhe ofrimi i SRA (Service Management tool).*
- *Shërbime kompjuterike për përdoruesin fundor (End User Compute) – Ofrimi i Shërbimit Global të Desk-ut (Global Service Desk), suporti i site-it dhe shërbime të centralizuara EUC si mesazhet, Direktoria Aktive (Active Directory), dhe Citrix.*
- *Rrjeti (Network) – Ofrimi i shërbimeve në lidhje me të dhënat, shërbimeve zanore dhe shërbimeve të sigurisë së rrjetit për qëllimet e infrastrukturës së rrjetit Avon.*
- *Data Center – Ofrimi i shërbimeve të qendrës së të dhënave duke përfshirë njësinë qendrore, AS400, Windows, Linux, UNIX, shërbimet e ruajtjes dhe backup-it të të dhënave të ruajtura në qendrat e të dhënave Avon.*
- *Shërbimet Cloud (Cloud Services) – Kontrata përfshin shërbimet cloud në qendrën e të dhënave HPE Frankfurt si një opsion. Nëse Avon dëshiron të lëvizë të dhënat Avon drejt HPE cloud, Avon dhe HPE do të përcaktojnë ngarkesën që do të migrohet nga qendra e të dhënave Avon në shërbimet cloud HPE gjatë periudhës tranzitore”.*

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave, citojmë: *“Përpunimi do të kryhet mbi bazën e Kontratës së Përpunimit të të Dhënave midis “AVON” dhe “HP Enterprise Services LLC” të vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Klauzolave Standarde Kontraktuale së bashku me shtojcat 1 dhe 2. Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave të cilat janë objekt transferimi do të jetë në përputhje me ligjet e zbatueshme. Duke qenë se të dhënat që janë objekt i këtij formulari mblidhen nga kontrolluesi subjekt i ligjit tonë për subjektet e të dhënave në Shqipëri, koha e ruajtjes së të dhënave përcaktohet në mënyrë specifike duke u mbështetur në Kodin e Punës (të ndryshuar), sipas të cilit *“të dhënat personale të përpunuara në dosjen e punëmarrësit ruhen deri në përfundim të marrëdhënies së punës. Përpunimi i të dhënave në tejkalim të këtij afati bëhet me marrjen e pëlqimit të punëmarrësit”.* Në çdo rast, të dhënat nuk mund të ruhen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin e përpunimit”.*

Në bazë të Vendimit të Komisionerit Nr. 8, datë 31.10.2016 *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, SHBA nuk është në listën e vendeve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Në këto kushte në zbatim të nenit 9 pika 1, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, subjekti kontrollues AVON COSMETICS Albania Sh.p.k ("AVON") është në kushtet ku ky transferim duhet kryer pas marrjes së Autorizimit nga Komisioneri mbi ligjshmërinë e realizimit të tij.

Për këtë qëllim subjekti përveç Formularit të Aplikimit ka depozituar një sërë dokumentesh në mbështetje të kërkesës së tij për të legjitimuar transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në marrësin e sipërcituar dhe konkretisht:

Marrëveshje Përpunimi dhe Transferimi Ndërkombëtar të të dhënave, lidhur ndërmjet Avon dhe Ofruesit të Shërbimit, Klauzolat Standarde Kontraktuale së bashku me shtojcat 1 dhe 2 të saj. Deklaratën e pëlqimit të subjekteve të të dhënave objekt transferimi.

Në mbështetje të dokumentacionit të paraqitur nga kontrolluesi dhe studimi i përmbajtjes së tyre rezultojnë që ky transferim të dhënash personale të jetë në përputhje me respektimin e mbrojtjes së të dhënave personale sipas akteve ndërkombëtare dhe vendase, dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Udhëzimit nr. 41, datë 13.06.2014 për "Lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale".

Sa më sipër, kërkesa për marrjen e autorizimit nga Komisioneri për transferimin e të dhënave personale nga kontrolluesi AVON COSMETICS Albania Sh.p.k ("AVON"), është në kushtet ku ky transferim mund të kryhet në marrësin e deklaruar sipas Formularit të Aplikimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, shkronja b, c nenit 9, pika 2 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

V E N D O S A :

1. Lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale nga kontrolluesi AVON COSMETICS Albania Sh.p.k ("AVON"), duke përcaktuar si më poshtë:

Kontrolluesi AVON COSMETICS Albania Sh.p.k ("AVON") lejohet të transferojë tek marrësi i të dhënave HP Enterprise Services LLC të vendosur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kategorinë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave punëmarrës, përfaqësuesit e kontrolluesit, si më poshtë:

- Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja);
- Numri personal i identifikimit;
- Jeta profesionale;
- Numri i sigurimit shoqëror;
- Formimi, Diplomat, Medaljet;
- Adresa, (karakteristikat e banesës);
- Telefoni fiks, të dhëna bankare, kontakt emergjence.

2. Të dhënat e cituara më sipër do të transferohen vetëm për qëllimin e deklaruar nga transferuesi në Formularin e Aplikimit për Autorizim mbi Transferimin e të Dhënave

Personale, të paraqitur pranë Komisionerit dhe që ka të bëjë me përforsimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, ti mundësohet outsourcing disa shërbimeve të teknologjisë së informacionit HP Enterprise Services ("HPES").

3. Të dhënat personale të lejuara për t'u transferuar (parashikuar në pikën 1), do të ruhen deri në përfundim të marrëdhënies së punës.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u dha sot më datë 9/2 2017

